



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Prenuar nga data: 27.03.2026			
Klasifikimi	Nr.	Str.	Tit.
	01	726	

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA		INSTITUTI HISTORISE - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA HISTORIJU	
Njësia Org.	Nr. i prot.	Logo	
Org. Ush.	Str. N.	01/61/26	
Org. Jed.	Str. Prot.		
Nr. Faqeve	Dati:	27.03.2026	
No. Fages	Date:		
Br. Stranica	Datum:		
4 faqe			
MEMORANDUM BASHKËPUNIMI		PRISHTINË - A	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN, FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE

DHE

INSTITUTIT TË HISTORISË "ALI HADRI", PRISHTINË

PREAMBULA

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë mbi bazën e misioneve dhe objektivave institucionale, si dhe fushave të përbashkëta të interesit, ky Memorandum paraqet një angazhim për të promovuar njohuritë shkencore dhe për të përcaktuar fushat dhe objektivat e bashkëpunimit ndërmjet:

Universitetit Publik "Kadri Zeka" dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, të përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku dhe Dekani, Prof. Asoc. Dr. Selim Daku, me seli në Rrugën: Zija Shemsiu, nr. 183, Gjiilan, 60000, Rep. e Kosovës,

dhe

Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, institucion kërkimor-shkencor publik me seli në Rrugën "Eqrem Çabej", Prishtinë, përfaqësuar nga Drejtoresha, Znj. Teuta Shala-Peli, më poshtë referuar si "Palët", të cilat bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum në përputhje me parashikimet e Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare nr. 04/L-037), si dhe Ligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore nr. 04/L-135 të Republikës së Kosovës, si dhe rregulloret dhe statutet përkatëse të secilit institucion.

Neni 1: Qëllimi

Ky Memorandum ka për qëllim të nxisë bashkëpunimin akademik, shkencor dhe kulturor ndërmjet palëve, duke promovuar kërkimin shkencor, zhvillimin e stafit akademik, angazhimin e studuesve të rinj dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes të ndërsjellë.

Neni 2 : Fushat e Bashkëpunimit

Në përputhje me qëllimin e mësipërm, bashkëpunimi në mes Fakultetit të Shkencave Sociale/ Universitetit Publik "Kadri Zeka" dhe Institutit të Historisë "Ali Hadri" do të përfshijë:

1. Organizimin e konferencave, simpoziumeve, tryezave shkencore dhe trajnimeve profesionale;
2. Hartimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe botuese;
3. Shkëmbimin e burimeve dhe përvojës shkencore, përfshirë dokumentacion arkivor dhe studimor;
4. Angazhimin e stafit në role kërkimore, recensuese dhe këshillimore;



5. Mbështetjen e pjesëmarrjes së studiuesve dhe studentëve në projekte të përbashkëta.
6. Që të organizojnë cikël ligjeratash ku do të angazhohen studiuesit e Institutit të Historisë në ato tema ku janë të specializuar.
7. Mundësimin e përfshirjes së punonjësve të Institutit të Historisë në programet e të gjitha cikleve të studimeve në UKZ.
8. Shkëmbimin e botimeve dhe materialeve të tjera akademike.
9. Shfrytëzimin e bibliotekave të të dy institucioneve nga stafi dhe studentët e UKZ-së;
10. Çdo formë tjetër bashkëpunimi që mund të dakordohet në vijim me marrëveshje të veçantë.

Neni 3: Parime të Përgjithshme

1. Bashkëpunimi bazohet në respektimin e autonomisë institucionale, barazisë dhe transparencës.
2. Palët zotohen të kontribuojnë në bashkërendimin e aktiviteteve në përputhje me ligjet në fuqi dhe objektivat përkatës institucionale.
3. Çdo veprimtari do të ndërmerret në frymën e besimit dhe partneritetit të ndërsjellë.

Neni 4: Format e Bashkëpunimit

- 4.1 Format e bashkëpunimit përfshijnë, por nuk kufizohen në:
- Publikime të përbashkëta;
 - Vizita studimore dhe shkëmbime akademike;
 - Zbatim projektesh të përbashkëta kërkimore.
- 4.2 Kërkesat për veprimtari të përbashkëta i drejtohen palës tjetër me shkrim, me përshkrim të qartë të qëllimit dhe afatit kohor.

Neni 5: Respektimi i Drejtave të Pronësisë Intelektuale

- 5.1 Palët angazhohen për të respektuar të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhura me çdo produkt, projekt ose material të zhvilluar si pjesë e bashkëpunimit.
- 5.2 Çdo krijim, inovacion, botim, ose projekt që përfshin pronësi intelektuale, përkatësia e të cilit është e lidhur me aktivitetet e bashkëpunimit, do të ketë një marrëveshje të veçantë për ndarjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, të cilat do të bien dakord nga të dyja palët.
- 5.3 Palët do të sigurojnë që çdo shfrytëzim i pronësisë intelektuale të bëhet në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse, si dhe do të respektojnë të drejtat e autorëve dhe krijuesve.

Neni 6: Përdorimi i burimeve dhe infrastrukturës

- 6.1 Palët do të angazhohen për të ndarë dhe përdorur në mënyrë të përbashkët burimet dhe infrastrukturën që nevojiten për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, duke përfshirë laboratorët, bibliotekat, pajisjet dhe teknologjitë përkatëse.
- 6.2 Çdo përdorim i burimeve dhe infrastrukturës nga ana e palëve do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e brendshme të secilës palë, duke siguruar që ato të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe të sigurt.



Neni 7: Promovimi i bashkëpunimit

- 7.1 Palët bien dakord për promovimin e këtij bashkëpunimi përmes aktiviteteve publike dhe informuese, të tilla si konferenca, seminare dhe publikime në faqet zyrtare të UKZ-së dhe IH.
- 7.2 Informacioni mbi aktivitetet dhe rezultatet e bashkëpunimit do të publikohet në mënyrë transparente dhe të aksesueshme.

Neni 8: Aspektet Financiare

- 8.1 Palët do të përpiqen të kontribuojnë në mbulimin e shpenzimeve që lidhen me aktivitetet e bashkëpunimit, në përputhje me mundësitë dhe burimet e tyre, si dhe në bazë të marrëveshjeve specifike të dakordësuara rast pas rasti.
- 8.2 Çdo angazhim financiar do të përcaktohet dhe formalizohet përmes dokumenteve të veçanta, të miratuara nga të dyja palët përpara fillimit të aktivitetit përkatës.
- 8.3 Asnjëra nga palët nuk është e obliguar për asnjë lloj të detyrimit financiar.

Neni 9: Koordinimi dhe komunikimi ndërmjet palëve

- 9.1 Çdo palë do të caktojë një ose më shumë përfaqësues të autorizuar për të koordinuar dhe mbikëqyrur zbatimin e memorandumit.
- 9.2 Përfaqësuesit e palëve do të kenë përgjegjësinë për komunikimin e rregullt, ndarjen e informacionit dhe menaxhimin e aktiviteteve të bashkëpunimit për të siguruar realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë memorandum.
- 9.3 Në rast ndryshimesh në përfaqësuesit e caktuar nga palët, këto duhet të njoftohen menjëherë dhe në mënyrë të shkruar nga pala përkatëse.
- 9.4 Palët do të sigurojnë që komunikimi të jetë i qartë, efektiv dhe të mbështesë bashkëpunimin përmes kanalëve të përshtatshme dhe të sigurt.

Neni 10: Konfidencialiteti

- 10.1 Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve, dokumenteve dhe të dhënave që shkëmbehen në kuadër të këtij Memorandumi.
- 10.2 Informacioni konfidencial nuk mund të zbulohet apo shpërndahet palëve të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës që ka dhënë informacionin, përveç rasteve kur kjo është e detyruar me ligj.
- 10.3 Angazhimi për konfidencialitet do të mbetet i vlefshëm edhe pas përfundimit të Memorandumi.

Neni 11: Kohëzgjatja

- 11.1 Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet e vlefshme deri në momentin kur njëra palë të shprehë me shkrim vullnetin për ta përfunduar.
- 11.2 Ai mund të ripërtërihet me dakordësi të përbashkët me shkrim.



Neni 12: Ndryshimet dhe shtesat në Memorandum

12.1 Çdo ndryshim ose shtesë në këtë memorandum do të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve dhe duhet të formalizohet me shkrim.

12.2 Çdo ndryshim, shtesë ose përmirësim i memorandumit do të konsiderohet si pjesë e saj dhe do të ketë të njëjtën fuqi ligjore si memorandum origjinal.

12.3 Ndryshimet ose shtesat në memorandum do të nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë dhe do të bëhen pjesë e memorandumit vetëm pasi të jenë miratuar dhe nënshkruar nga të dyja palët.

12.4 Palët do të angazhohen që çdo ndryshim të bëhet në mënyrë transparente dhe të dokumentuar, për të siguruar që të dyja palët janë në dijeni të angazhimeve të reja që lindin nga çdo modifikim.

Neni 13: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

13.1 Palët angazhohen të zgjidhin çdo mosmarrëveshje me mirëbesim dhe konsultime miqësore.

13.2 Secila palë ka të drejtë të tërhiqet nga Memorandumi me njoftim me shkrim. Memorandumi mbetet në fuqi për 30 ditë pas njoftimit, pa cënuar aktivitetet që janë në proces.

Ky Memorandum është përgatitur në dy kopje origjinale, një për secilën palë, dhe ka fuqi të barabartë ligjore.

PËR: UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN		PËR: FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE		PËR: INSTITUTIN E HISTORISË "ALI HADRI" PRISHTINË	
Emri:	Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku	Emri:	Prof. Asoc. Dr.Selim Daku	Emri:	Prof. Dr. Teuta Shala Peli
Pozita:	Rektor	Pozita:	Dekan	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:	
Data/ Vendi:	<u>27.03.</u> 2026, Gjiilan	Data/ Vendi:	<u>27.03.</u> 2026, Gjiilan	Data/ Vendi:	<u>27.03.</u> 2026, Gjiilan

